

PYETJET E HISTORISE SE ARTIT

Departamenti i Skulpturës

Pyetjet janë të ndara në numra rendor dhe çdo numër përmban tre nënpyetje:

- a** - Nga historia e artit botëror
- b** – Nga historia e artit shqiptar
- c** - Nga specialiteti i zgjedhur

Pyetjet shërbejnë për njërën nga fazat e konkursit të pranimit të studentëve në Universitetin e Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura. Krahas konkurimit praktik në pikturë, skulpturë dhe vizatim, studenti testohet edhe teorikisht për njohuritë e tij rreth Historisë së Artit botëror, shqiptar me specifikisht mbi specialitetin e përzgjedhur.

Pyetjet shërbejnë si një orientim fillestar në bashkëbisedim.

Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të bëjnë dhe pyetje shtesë kur ata e shohin të nevojshme.

Secili student tërheq pyetjet dhe përgjigjet në prani të komisionit.

Studenti ka të drejtë të tërheqë pyetjet deri në dy herë.

...

1.

a) Historia e artit ndahet në periudha. Citoni në mënyrë kronologjike nga Prehistoria e deri në ditët tona, disa prej tyre.

b) Cili është autori i monumentit të Skënderbeut që është vendosur në sheshin qendror të Krujës? Në cilin qytet është vendosur kopja e kësaj veprë vitet e fundit?

c) Vazot e qeramikës datojnë që nga fillimet e njerëzimit. Flisni për teknologjinë e ndërtimit të tyre.

2.

a) Dëshmitë e para artistike shfaqen në një periudhë që quhet “Prehistorike”. Pse quhet e tillë? Çfarë e bën këtë periudhë të ndryshme me periudhat historike që pasojnë? Përshkruani një vepër karakteristike të periudhës së prehistorisë.

b) Cilët janë autorët e monumentit të Skënderbeut që ndodhet në sheshin e Tiranës? Në ç’periudhë u realizua ajo?

c) Si realizohet një vepër në bronz. Shpjegoni në cilat etapa kalon realizmi i saj.

3.

a) Përmend disa nga dëshmitë artistike me të rëndësishme të artit klasik Grek, në skulpturë. Pse u quajt “Klasike” dhe në cilën periudhë tjetër të artit pati influencë të dukshme?

b) Cito tre piktorë të periudhës Pasbizantine në Shqipëri. Në muzeun e cilit qytet ruhet koleksioni më i madh i ikonave në Shqipëri?

c) Cili është autori i monumentit të parë në Shqipëri dhe cila është vepra që ai krijoi?

4.

a) Cila është tema qendrore në pikturat e vazove të periudhës së artit Grek? Cito tre emra skulptorësh të shquar në artin Klasik Grek. Cito nga një vepër për secilin.

b) Cili është autori i pikturës “Vojo Kushi” që ndodhet në Galerinë Kombëtare të Artit, Tiranë.

c) Cito tre vepra të skulptorit Odhise Paskali. Përshkruajini ato dhe flisni për kushtet historike në të cilat ato u realizuan.

5.

a) Cito emrat e pesë skulptorëve italian. Fol më zgjeruar për njërin prej tyre.

b) Në cilin qytet të Shqipërisë gjendet muzeu “Onufri”? Çfarë përmban ky muze?

c) Cito emrat e pesë skulptorëve të Realizmit socialist në Shqipëri. Fol më zgjeruar për njërin prej tyre dhe karakteristikat kryesore të krijimtarisë së tyre.

6.

a) Ç’përfaqëson Futurizmi? Kush ishte përfaqësuesi i tij? Cito një vepër futuriste në skulpturë apo në pikturë.

b) Cito emrat e dy skulptorëve qeramistë në Shqipëri. Flisni më gjatë për teknologjinë e qeramikës në vendin tonë.

c) Cilët janë autorët e Monumentit të Pavarësisë në Vlorë. Shpjegoni kontekstin e kohës kur u ngrit kjo vepër dhe përshkruani atë.

7.

a) Ç'përfaqson Kubizmi? Cito emrat e dy piktorëve kubistë. Cila është vepra e parë që zyrtarisht u etiketua kubiste?

b) Cito një veper te artit viziv shqiptar qe te ka lene me shume mbrese dhe bej nje koment rreth saj.

c) Flisni për një skulptor bashkohor shqiptar. Shpjegoni me fjalët tuaja veprën e tij. Citoni një ekspozitë personale të tij dhe flisni rreth saj.

8.

a) Ç'përfaqson Surrealizmi? Kush janë përfaqësuesit më të spikatur të tij? Përmend titullin e një vepre surrealistike.

b) Ku ndodhet sot skulptura “Dea e Butrintit”? Bëni një shpjegim të saj dhe periudhës artistike kur ajo është realizuar.

c) Citoni një skulpturë në mermer që keni parë. Shpjegoni teknikën që duhet për të realizuar një skulpturë të tillë.

9.

a) Cito disa piktorë dhe skulptorë të Rilindjes italiane. Cili është autori i pikturës “Primavera” që gjendet në muzeun “Uffici”? Si quhej artisti italian qe njekohesisht ishte dhe mesuesi i L.Da Vinçi?

b) Cito një ekspozitë të arteve vizive që ke vizituar në Shqipëri dhe komento gjere rreth saj.

c) Citoni një vepër të skulptorit Shaban Hadëri dhe përshkruajeni atë.

10.

a) A ekzistonte në Egjiptin e lashtë një kanon artistik? Ku gjente zbatim dhe si shprehej ky kanon? Jep një shembull konkret dhe komento rreth tije.

b) Cito nje veper te piktorit Sadik Kaceli. Cito nje veper te piktorit Vangjush Mio.

c) Flisni për skulptorin Hektor Dule dhe Perikli Çuli. Citoni disa vepra të tyre dhe përshkruajini ato.

11.

a) Ku gjenden respektivisht shpellat “Lasceaux” dhe “Altamira”? Bëj një përshkrim të pikturës së shpellave, figurave shenjave dhe destinacionin e tyre në shoqërinë primitive.

b) Cili është autori i skulpturës monumentale Heronjtë e vigut? Shpjegoni kontekstin kohor kur është realizuar kjo vepër.

c) Flisni për instalacionin, karakteristika dhe ndryshimi i tij nga skulptura. Përshkruani secilën prej tyre.

12.

a) Kush është autori i skulpturës “Pieta” që gjendet në Vatikan? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfare trajton ajo? Përmend disa vepra të rëndësishme të këtij autori.

b) Cito disa vepra të skulptorit Thoma Thomai. Përshkruani njëren prej tyre

c) Çfarë është një shtatore? Ku ndryshon ajo nga format e tjera të skulpturës?

13.

a) Kush është autori i pikturës murale “Darka e fundit”? Ku ndodhet ajo? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfare trajton ajo? Përmend disa vepra të rëndësishme të këtij autori.

b) Cili është autori i grupit skulpturor në ambjentet e brendshme të Muzeut të Krujës. Flisni për këtë vepër.

c) Kush ishte Janaq Paço? Flisni për jetën dhe krijimtartinë e këtij skulptori shqiptar. Citoni disa vepra nga kya autor.

14.

a) Cito disa nga dëshmitë më të rëndësishme artistike të artit Romak,ne skulpture.Cili qe shkaku qe arti romak u influencua nga arti grek?

b) Kur u shfaq metoda e “Realizmit Socialist” ne Shqiperi dhe cili ishte tipari themelor i tij? Cito nje veper tipike te Realizmit socialist shqiptar.

c) Thoni emrat e 5 skulptorëve bashkohor shqiptar dhe disa nga ekspozitat e tyre personale. Flisni më gjatë për njërin prej tyre.

15.

a) Cila është tema qëndrore në artin Bizantin? Ne cilat teknika realizoheshin keto tema?

b) Kush janë autorët e skulpturës monumentale “Nënë Shqipëri” që ndodhet tek varrezat “Dëshmorët e Kombit” ne Tirane?

c) Citoni disa teknika të skulpturës në periudha të ndryshme, flisni më gjatë për njërin prej tyre.

16.

a) Flisni për artin Egjyptian? Shpjegoni karakteristikat, kanonet dhe kohëzgjatjen e tij. A ndikoi organizimi politik, shoqëror dhe fetar në krijimin e këtyre kanoneve?

b) Cila është tema qendrore e piktorit Abdurrahim Buza? Cito titullin e një vepre të tij.

c) Cili është autori i skulpturës “Fan Noli ” pranë “Akademisë së Shkencave” në Tiranë?

17.

a) Cito disa nga dëshmitë artistike me të spikatura të periudhës Gotike. Fol më gjërë për njërin prej tyre.

b) Cili është autori i tabllosë “Dasma Shkodrane”. Ku gjendet sot kjo veper? Cito një veper tjetër po të këtij autori.

c) Flisni për skulptorin Odhise Paskali. Citoni 5 nga veprat e tij kryesore. Flisni për ndryshimet në krijimtarinë e Paskalit, para dhe pas Luftës.

18.

a) Kush është autori i Kapelës Sistine në Vatikan. Ku ndodhet kjo veper? Çfarë trajtohet në këtë veper? Përmend disa vepra të rëndësishme të këtij autori.

b) Citoni ndryshimet mes skulpturës së Realizmit socialist në Shqipëri dhe në atë pas saj.

c) Citoni dy monumente që keni parë në qytetin e Shkodrës dhe dy në atë të Korçës. Përshkruani ato.

19.

a) Një nga periudhat në historinë e artit u quajt “Rilindje”. Pse u quajt e tille? Ku lindi fillimisht dhe ku u shfaq më pas ajo?

b) Cito disa karakteristika të artit Bizantin, ne arkitekture, skulpture, pikturë. Ç’është Ikona? Afresku? Mozaiku?

c) Cilët janë autorët e monumentit “Nënë Shqipëri”. Në cilin vit u ngrit ajo dhe në çfarë kushtesh politike? Bëni një përshkrim të kësaj veprë monumentale.

20.

a) Cito emrat e dy autorëve të periudhës neoklasike. Cili është autori i tablosë “Marati i vrarë”? Përmend edhe dy tabllo të tjera të po këtij autori.

b) Cito emrat e disa piktorëve shqiptarë para Luftës së Dytë Botërore. Flisni për karakteristikat e artit në këtë periudhë.

c) Flisni për skulptorin Andrea Mano dhe përmendni disa vepra nga krijimtaria e tij. Cili është monumenti më i rëndësishëm i tij në Tiranë. Përshkruajeni atë.

21.

a) Flisni për periudhën e arti Barok. Në cilën periudhën historike shtrihet ajo dhe cilat ishin karakteristikat e saj. Flisni për një skulptor të artit barok.

b) Flisni për piktorin Abdurrahim Buza. Në cilën periudhë jetoi ai?

c) Flisni për skulptorin Muntaz Dhrami dhe përmendni disa vepra nga krijimtaria e tij.

22.

- a. Çfarë është Post impresionizmi dhe kur lindi ai? Përmendi disa nga protagonistët e kësaj periudhe artistike.
- b. Cili ishte skulptori Antuan Burdel? Kujt periudhe i përket ai dhe cilat ishin karakteristika e krijimtarisë së tij?
- c) Flisni për skulptorin Kristaq Rama dhe përmendni disa vepra nga krijimtaria e tij.

23.

- a. Kur lindi Impresionizmi dhe pse? Përmendni disa nga pionerët e kësaj rryme artistike.
- b. Përmendi emrat e disa skulptorëve shqiptar të fundshek XX. Flisni për ndryshimet mes tyre.
- c. Shpjegoni procesin e derdhjes së një skulpture në allçi.

24.

- a. Kush ishte piktori Van Gogh. Cilës periudhë artistike i takon ai dhe çfarë temash trajtoi?
- b. Kush është piktori Guri Madhi? Përmendni disa nga veprat e këtij autori.
- c. Shpjegoni etapat kryesore të realizimit të një skulpture.

25

a. Kush ishte skulptori Auguste Roden dhe ku qëndron vlera e tij në historinë e artit?

b) Kush është piktori Fatmir Haxhiu ? Përmendni disa nga veprat e këtij autor dhe periudhën në cilën ai krijoi.

c) Flisni për skulptorin Perikli Çuli dhe përmendni disa vepra nga krijimtaria e tij.

26.

a. Kush ishte skulptori Henry Moore dhe ku qëndron vlera e tij në historinë e artit? Cilës periudhë artistike i takon ai?

b) Flisni për një skulptor bashkohor shqiptar. Përmendni disa nga veprat e tij.

c. Përshkruani një skulpturë monumentale. Çfarë e bën atë të konsiderohet e tillë?

27.

a) Kush ishte skulptori Alberto Giacometti? Për çfarë dallohet vepra e tij.

b) Kush është piktori Sali Shijaku? Përmendi disa nga veprat e këtij autori dhe përshkruani njërën prej tyre? cilës periudhë artistike i takon ai?

c. Shpjegoni ndryshimet mes një figurine, busti, shtatore dhe monamenti.

Bibliografia

Historia e Artit / Ernest Gombrich

Historia e Artit Shqiptar 2 / Andon Kuqali

Arti Pamor 10 / Silva Nini & Ermir Hoxha

Përgatiti Dr. Ermir Hoxha

Tiranë, janar 2017